

PKR.nr.421/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Naser Foniqi, me sekretaren juridike Sevdije Breznica, si procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit K.B., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.1182/2013, të datës 01.08.2014, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 17.07.2018, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit Besa Limani dhe i akuzuari K.B., të njëjtën ditë, me datë 17.07.2018, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari K.B., i biri i Xh. dhe V., e vajzërisë H., i lindur me datë ..., në fshatin G., Komuna M., ku edhe jeton, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar- baba i ... fëmijëve, i punësuar – realizon pagë mujore prej ... euro, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: në kundërshtim me ligjin për armët apo materiet plasëse, ka mbajtur armë të tilla, në atë mënyrë që me datë 13.11.2013, gjatë kontrollit të pasagjerit në Aeroportin e Prishtinës “Adem Jashari”, nga njësitë me rreze x, në valixhen e të akuzuarit është gjetur dhe sekuestruar arma elektroshok e tipit “1101 Flachlight”, në formë baterie për ndriçim, ngjyrë e zezë, modeli police, me kapacitet 8000 W, e prodhimit Gjerman, të cilën armë policia e ka gjetur te i akuzuari në prag të nisjes së tij për H.,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 41; 46; 73 dhe 374, par. 1 dhe 3, të KPRK, si dhe nenit 365, të KPPK, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- **Në shumë prej katërqind (400) €**, të cilin dënim, i pandehuri **K.B.**, obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, me pëlqimin e të pandehurit gjykata do ta zëvendësoj dënimin me gjobë në urdhër për punë në dobi të përgjithshme, e nëse i dënuari nuk e jep pëlqimin gjykata do t'i caktoj një ditë burgimi për 20 € të gjobës.
- Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të

paguaj shumën prej **50 €**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

- Të akuzuarit i konfiskohen arma, model “Police 1101 Flachlight”, në formë baterie për ndriçim, ngjyrë e zezë, me kapacitet 8000 W, e cila është si rezultat i kryerjes së veprës penale.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.nr.1182/2013, të datës 01.08.2014, e ka akuzuar të pandehurin K.B., për shkak të veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 372, par. 1, në tentativë, lidhur me nenin 28, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 17.07.2018, para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit ka theksuar se në këtë çështje penale sa i përket veprës penale të cilën ngarkohet i pandehuri K.B., duhet të bëhet rikualifikimi i veprës penale sipas aktakuzës nga vepra penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 372, par. 1, në tentativë, lidhur me nenin 28, të KPRK, në veprën penale mbajtjen në pronësi, posedim apo shfrytëzim i pa autorizuar të armëve nga neni 374, par. 1 të KPRK, sepse pas analizimit kam gjetur se përmbushen elementet e kësaj vepre penale.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari K.B., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, si dhe ka shtuar se e ka parasysh natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë. Pastaj, i akuzuari ka thënë se kur e ka blerë këtë elektroskok në M., në vlerë prej 8 euro, të njëjtën e ka blerë duke menduar se është bateri, duke theksuar se po ta kishte ditur se e njëjta është armë nuk do ta kishte blerë kurrë. Po ashtu, i akuzuari ka kërkuar nga gjykata që nëse e shpallë fajtor, atij t’i shqiptoi një dënim më të lehtë, duke njoftuar se nga paga e tij prej 1900 euro, të cilën e realizon nga puna që bën në H., mban familjen e tij 6 anëtarëshe, paguan qiranë për banesën ku jeton dhe i ndihmon familjes së tij në Kosovë.

Sa i përket pranimin të fajësisë nga i akuzuari, Prokurori i Shtetit, ka deklaruar, se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që konsideron se i akuzuari këtë pranim e ka bërë në bazë të vullnetit të tij të lirë, pas njoftimit nga gjykata për benefitet dhe pasojat e pranimin të fajit.

Pas deklarimit të të pandehurit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria, kryetari i trupit gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit

gjkata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: sjelljen e mëparshme të të akuzuarit; pranimin e fajit dhe sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar, si dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale; ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi që të pandehurit t'i merret sendi i përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 375, par. 3, të KPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 17.07.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.421/14, datë 17.07.2018.

Sekretare juridike,
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.